



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 16 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 73/10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 04/10

Parashtrues të kërkesës

Xhafer Maliqi dhe të tjerë

kundër

Odës së Avokatëve të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Xhafer Maliqi, Bajram Maraj, Betim Shala, Feriz Gërvalla, Jonuz Rama, Iliriana Osmani Serreqi, Ramë Dreshaj, Mexhid Sylja, Fazli Balaj, Arianit Koci dhe Burim Xhemajli, prej të cilëve Bajram Maraj, Betim Shala, Feriz Gërvalla, Ramë Dreshaj, Bajram Tmava, Mexhid Sylja, Fazli Balaj dhe Burim Xhemajli përfaqësohen nga Xhafer Maliqi, i cili është avokat në Prishtinë.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Oda e Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "OAK").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se anëtarët e Kuvendit të OAK-ut, në përbërjen e tyre në mbledhjes së 19 shtatorit 2009, morën vendime që nuk janë në pajtueshmëri me Ligjin në fuqi për Avokatinë dhe kundërshtim me nenin 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Kushtetuta"), neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtutjeshëm: "Ligji") dhe neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Rregullorja e Punës").

Procedurat para Gjykatës

5. Më 20 janar 2010, Parashtruesit dorëzuan kërkesën pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: "Gjykata"), bashkë me autorizimin ligjor, të nënshkruar nga parashtruesit e tjerë, më datë 22.01.2010.
6. Më 24 mars 2010, Kërkesa iu komunikua Kryetarit të OAK-ut, i cili, deri më tani, nuk ka dorëzuar asnjë koment.
7. Më 15 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtarit Raportues, Robert Carolan, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga Gjyqtari Almiro Rodrigues (Kryesuesi), Zëvendës-kryetari Kadri Kryeziu dhe gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë.

Përmbledhje e fakteve

8. Në pajtim me nenin 3.3 të Ligjit Nr. 03/L-117, të shpallur më 12 shkurt 2009 (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji i ri), Pavarësia e avokatisë arrihet përmes organizimit të avokatëve nëpërmjet Odës së Avokatëve, si organizatë e pavarur publike.
9. Në pajtim me nenin 22 të Ligjit të ri, Kuvendi i OAK-ut përbëhet nga të gjithë anëtarët e OAK-ut, ndryshe përbërja me 78 anëtarët me ligjin e mëhershëm.
10. Më 19 shtator 2009, Kuvendi i OAK-ut, në përbërjen e tij sipas ligjit të mëhershëm, u thirr në takim nga ana e Kryetarit aktual: për miratimin e Statutit të OAK-ut dhe Rregulloreve tjera të OAK-ut; si dhe për të zgjedhur Kryetarin e OAK-ut, Zëvendësin dhe anëtarët e Bordit të OAK-ut
11. Një anëtar i Kuvendit si duket ka sugjeruar se takimi i Kuvendit me rendin e propozuar të ditës nuk mund të mbahet, sepse nuk do të jetë në gjendje të merr vendime të ligjshme, nëse përbërja do të ishte në pajtim me Ligjin e ri. Propozimi i tij u vendos për votim para Kuvendit dhe u hodh poshtë.
12. Si rrjedhojë, të gjitha vendimet janë marrë me anë të shumicës së votave të anëtarëve të pranishëm që votojnë, sipas ligjit të mëhershëm.

Pretendimet e parashtruesve

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se më 19 shtator 2009, Kuvendi i OAK-ut është tubuar, ka miratuar statutin e ri të OAK-ut dhe rregulloret tjera, ka zgjedhur Kryetarin dhe organet tjera të reja në pajtim me dispozitat e ligjit të vjetër (Ligji për avokatinë dhe asistencën tjetër ligjore, Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr: 011-69/79) dhe jo sipas Ligjit të ri (Nr. 03/L-117) për Avokatinë e cili tanimë ishte në fuqi më atë datë.
14. Prandaj, Parashtruesit e kërkesës, janë ankuar se Kuvendi i OAK-ut, është mbledhur më 19 shtator 2009 në kundërshtim me Ligjin e ri për avokatinë.
15. Prandaj, OAK-u nuk ka mundur t'i miratojë vendimet më 19 shtator 2009 ashtu siç ka vepruar, sepse, sipas nenit 22 (2) të Ligjit të ri për avokatinë, Kuvendi është dashur të jetë në përbërje të të gjithë anëtarëve të Avokatisë, d.m.th. të gjithë 500 anëtarët e regjistruar. Megjithatë, janë mbledhur vetëm 78 prej tyre (që është numri i anëtarëve të Kuvendit sipas ligjit të vjetër), nga të cilët 55 ishin të pranishëm. Kjo do të thotë se anëtarët tjerë të regjistruar ishin viktimë të shkeljes së të drejtave të tyre për të marrë pjesë në takim; për t'i aprovuar rregulloret; dhe për të zgjedhur Kryetarin e Avokatisë dhe organet tjera, në pajtim me ligjin në fuqi.
16. Përmbledhtazi, Parashtruesit pretendojnë se anëtarët e Kuvendit të OAK-ut, në përbërjen e takimit të 19 shtatorit 2009, morën vendimet në vijim:
 - a. Vendimi për miratimin e Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës dhe akteve tjera të Odës së Avokatëve.
 - b. Vendimin për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Odës së Avokatëve të Kosovës.
 - c. Vendimin për zgjedhjen e Bordit të Odës së Avokatëve të Kosovës

Sipas mendimit të tyre, këto vendime nuk janë marrë në pajtim me Ligjin në fuqi për Avokatinë, por janë marrë në kundërshtim me nenin 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

17. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe më tutje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.
18. Në këtë kuptim, neni 113.7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
19. Në këtë kuptim, Gjykata dëshiron të theksojë se arsyeja prapa rregullit të shterimit është që autoritetet në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, ta kenë mundësinë e parandalimit apo korrigjimit të shkeljes së pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të ofrojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese. (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni v. Francë*, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite në procedurat në fjalë. Përderisa çështja është ngritur në mënyrë të nënkuptuar apo në

substancë, shterimi i mjeteve juridike do të jetë përmbushur (*shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas v. Qipro, nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004*).

20. Kjo Gjykatë e ka aplikuar këtë arsyetim me rastin e nxjerrjes së Vendimit më 27 janar 2010 për papranueshmëri në bazë të mosshterimit të mjeteve juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti nr. KI. 41 /09 dhe Vendimit të 23 marsit 2010 në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rasti nr. KI 73/09.
21. Kjo Gjykatë në Kërkesë nuk e ka adresuar nëse statuti i OAK-së e shkel Kushtetutën, sepse kjo pyetje nuk është ngritur në Kërkesën e Parashtruesve. Gjykata vëren se kjo çështje duhet të jetë e ngritur, në qoftë se ngrihet, para gjykatave të rregullta.
22. Për sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata thekson se ligji në fuqi në kohën e ngjarjeve, që është bazë e ankesës së Parashtruesit, është Ligji nr. 03/L-117 për Avokatinë, i shpallur më 12 shkurt 2009. Në nenin 28 [Mbikëqyrja dhe bashkëpunimi me organet tjera], Ligji përcakton se:

“1. Qeveria e Kosovës mbikëqyr ligjshmërinë e akteve të përgjithshme të Odës së Avokatëve dhe ka të drejtë që, gjër në vendimin e Gjykatës Supreme, të ndaloj ekzekutimin e aktit i cili është në kundërshtim me ligjin. Kjo mbikëqyrje kufizohet në përfilljen e ligjit dhe të së drejtës, duke mos e cenuar autonominë administrative të Odës së Avokatëve.”
23. Megjithatë, nga parashtrimet e Parashtruesve të kërkesës, duket se ata nuk e kanë ndjekur procedurën e përcaktuar në nenin 28(1) të Ligjit për Avokatinë. Prandaj, Gjykata nxjerr përfundim se Parashtruesit nuk i kanë shterur të gjitha mjetet juridike që kanë qenë në dispozicion për ta sipas ligjit në fuqi. Rrjedhimisht, Kërkesa duhet të refuzohet në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, Neni 47 të Ligjit, si dhe Neni 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 16 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. **TË REFUZOJË** Kërkesën si të Papranueshme.
- II. Ky vendim do t'i njoftohet Palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit.
- III. Ky Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Robert Carolan, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.